



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

*Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit/Ministarstvo Kulture, Omaladine i Sporta -
Ministry of Culture, Youth & Sports*

Emërtimi i strukturës së ministrisë/Ime strukture ministarstva/Name of the structure of the ministry

LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP

REFERENCË:					
PËR/ZA/TO:	Zyren e Kryeministrit Zt. Ramush Haradinaj, Kryeministër i Republikës së Kosovës				
CC:	Zt. Valon Tolaj, zv. Shef i Stafit në Kabinetin e Kryeministrit				
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Zt. Avni Arifi, Shef i Stafit në Kabinetin e Kryeministrit				
NGA/OD/FROM:	Burbuqe Bakija Deva, Zëvendësministre e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit				
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport 100 ditor i punës sime si Zëvendësministre e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit Periudha 03.01.2018 – 10.04.2018				
Nr. i zyrës: Br. kancelarije: Room No.:	038/ 200 22 043	Lokacioni: Kucni: Extension:	Prishtine	Data: Datum: Date:	10. 04. 2018
SIÇ ËSHTË KËRKUAR/KAKO JE ZATRAZENO/ AS REQUESTED					X

Raport i punës 100 ditore për periudhën 03.01.2018 – 10.04.2018

I nderuari Kryeministër,

Në vazhdim po ju prezantoj Raportin 100 ditor të punës sime si Zëvendësministre e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Periudha 03.01.2018 – 10.04.2018

Në kuadër të detyrave dhe përgjegjësi të mija të përcaktuara me Vendimin me nr. 118/217 të datës 16.10.2017, të lëshuar nga Kryeministri i Kosovës zt.Ramush Haradinaj, jam angazhuar në:

- Mbështetjen e Ministrit të *Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit*
- Menaxhimin e Aktiviteteve në fushën e Trashëgimisë Kulturore në përgjithësi, si dhe në fushat tjera si të Kulturës, Rinisë dhe Sportit
- Zëvendësimin e Ministrit ku ai nuk ka pasur mundësi të marrë pjesë
- Monitorimin e zbatimit të dokumenteve strategjike të MKRS-së
- Monitorimin e zbatimit të Legjislacionit të MKRS-së në fuqi
- Dhënia e kontributit profesional gjatë përpilimit të dokumenteve strategjike dhe Legjislative të MKRS-së
- Bashkëpunimi me Institucionet vartëse të MKRS-së
- Bashkëpunimi me Muzeun e Kosovës, Institutin Arkeologjik të Kosovës, Institutin e Kosovës për Mbrojtje të Monumenteve, si dhe Qendrat Rajonale për Trashëgimi Kulturore
- Bashkëpunimi me Galerinë e Kosovës,
- Bashkëpunimi me Institucionet Kulturore të nivelit Qendror dhe Lokal
- Bashkëpunimi me Organizata Jo-Qeveritare vendore dhe ndërkombëtare
- Bashkëpunim me Ambasadat për vazhdimin e përkrahjes së Kosovës në fushën e Kulturës dhe Trashëgimisë Kulturore, përmes projekteve të caktuara
- Bashkëpunim me Institucionet Ndërkombëtare për Trashëgimi Kulturore me qëllim të zbatimit të Memorandumeve të Mirëkuptimit, si dhe mundësia për vazhdimin e bashkëpunimit në të ardhmen
- Bashkëpunimi me Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore
- Bashkëpunimin me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
- Bashkëpunimin me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
- Bashkëpunim me Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", dhe universiteteve tjera private.
- Bashkëpunim me Nivelin Lokal - Komunat , për lehtësimin e procedurave dhe kompletimin e projekteve, me qëllim të realizimit të Projekteve të MKRS-së për Investimet Kapitale të parapara në KASH, si dhe projekteve nga subvencionet e MKRS-së
- Bashkëpunimi me Zyrën e Komisionit Evropian në Kosovë, për realizimin e projektit të Sallës Koncertale në Prishtinë

Faqe 2 nga 30

Adresa> Rr. "Nëna Terese" Nr.35, Kati i I-rë , homa 115 -10.000 Prishtinë-Kosovë

Telefoni 038211111 Mobili +377 41 350630

www.mkrs.ks-gov.orgE-mail: milot.mustafa@rks-gov.net

- Bashkëpunimi me Komunën e Mitrovicës, për funksionalizimin e objekteve sportive të financuara nga Komisioni Evropian
- Bashkëpunimi me KFOR-in në Kosovë, me qëllim të promovimit të vlerave të Trashëgimisë Kulturore të Kosovës
- Bashkëpunim me OSBE-në, me qëllim të promovimit të dialogut ndërkulturor dhe diplomacisë Kulturore në Kosovë
- Bashkëpunimi me Ministrinë e Kulturës së Shqipërisë, takime pune me zv. Ministren Valbona Shunjaku.
- Takime me Federatat e Sportit të Kosovës, si dhe pjesëmarrje në Aktivitetet e tyre
- Pjesëmarrje në Konferenca të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare
- Pjesëmarrje në tryeza diskutimi dhe debate

Disa nga aktivitetet

- Zëvendësimi i Ministrit në Takimet e rregullta të Qeverisë (7 takime)
- Pjesëmarrje dhe fjalë rasti në Hapjen e Aktivitetit “Dita Kombëtare e Vetëdijesimit për Biblioteka në Kosovë “ organizuar nga Biblioteka Kombëtare dhe Ambasada Amerikane në Kosovë për nder të 73-vjetorit të themelimit.



- Pjesëmarrje në shënimin e 105 vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë nga Ambasada e Shqipërisë në Kosovë.

- Pjesëmarrje dhe Fjalë rasti në Hapjen e Bibliotekës së Esad Mekulit, me rastin e shënimit të Ditës së Bibliotekës.



- Pjesëmarrje dhe Fjalë rasti në Hapjen Ekspozitës grupore të artistëve nga Maqedonia - "Esenca e ekzistencës", në Galerinë Kombëtare të Kosovës. Diskutim me përfaqësuesit e Ministrisë së Kulturës së Maqedonisë, për thellimin e bashkëpunimit.




Faqe 4 nga 30

- Takim me përfaqesueset e Korit të Grave "Lira", për organizimin e Festivalit Ndërkombëtar të Koreve të Grave në Kosovë
- Pjesëmarrje në ndarjen e çmimeve Fiqes të Organizar nga FIQ & Rockefeller Brothers në Hotel Emerald!
- Takim me Drejtoreshën e YMCA Dorina Lluka, me të cilën biseduam për fuqizimin e rinisë në Kosovë, si dhe mundësinë e mbështetjes së Ndertimit të Qendrës Rinore në Pjetershan.



- Takim në zyre me ambasadorin e futbollit Lorik Cana. Biseduam rreth aktiviteteve të MKRS-së në fushën e sportit dhe përkrahjes së të rinjve sportistë në vend, si një prej prioriteteve kryesore të politikave të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.



Faqe 5 nga 30


- Takim me Profesor Florim Isufi, anëtar i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore.



- Pjesëmarrje ne Mitingun e 53-të të Poezisë!
- Pjesëmarrje dhe fjalë rasti në Qendrën Kinematografike të Kosovës e cila ka nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi me GjirafaVideo.com për shfaqjen online të filmave të subvencionuar nga QKK në favor të interesit publik dhe në mënyrë që qytetarët të kenë qasje në filmat e Kosovës.



- Takim me Violinistin me famë botërore Shkelzen Doli, anëtarin e Filharmonisë së Vjenës, si dhe ideatorin dhe udhëheqësin artistik të projektit "Albanian Soul" zt. Shkëlzen Doli, me të cilin biseduam për bashkëpunimin tonë rreth promovimit më të madh të muzikës autoktone Shqiptare kudo në botë.



- Takim-Tringa Rexhepi (Këngëtare nga Kanada). Me deputimet e saj të shumta po arrin ta promovojë vendin tonë me shumë sukses në Kanada dhe me gjërë.



- Pjesëmarrje si paneliste në Organizim nga OSBE-ja për Takim me Publikun në Komunën e Prizrenit me temën: Trashëgimia Kulturore, Turizmi dhe Krijimi i vendeve të punës, Ndërlidhja në mes të Mbrojtjes së Trashëgimisë kulturore në Prizren, zhvillimi i turizmit dhe krijimi i mundësive të reja. Takim me George Katcarava, Ushtrues detyre në qendrën rajonale në Prizren.




Faqe 8 nga 30

- Takim-Emrah Cermjani(Drejtorin e OJQ-se të Minoriteteve Rome). Mundësi për mbështetje të disa projekteve që ndikojnë në promovimin e kulturës dhe identitetit të komuniteteve në fjalë, si dhe fillimi i përgatitjeve të përbashkëta të planit të punës për manifestimin e Ditës Ndërkombëtare të Romëve.



- Pjesëmarrje në Ekspozitën Trashëgimia Shpirtërore, përmes fotove, organizuar nga OJQ CHwB dhe Ambasada Amerikane në Prishtinë.



- Takim me përfaqësuesit e Grupit ASHIKËT .
Zhanri i këtyre këngëve popullore është thesar për vendin tonë dhe padyshim që meritojnë përkrahjen intisutcionale.




- Pjesëmarrje dhe shpërndarje e Çmimeve në Aktivitetin Sportisti i vitit 2017, të organizuar nga DKRS në Gjakovë




- Takim me Arta Haziri Nuhiu. Diskutim për kulturën në përgjithësi në Kosovë, sfidat dhe problemet me të cilat ballafaqohet ky sektor si dhe mundësinë e organizimit të festivalit Mollëkuqet.



- Pjesëmarrje dhe përkrahje për realizimin e Shfaqjes “Rojat e Taxhit”



- Takim me Profesorin e nderuar Zt. Shefki Stublla, Shkencëtarin pasionant të Muzeologjisë. Diskutim për mundesinë e bashkëpunimit me qëllim të ruajtjes, mbrojtjes dhe promovimit të Trashëgimisë Kulturore. Dhurimi i botimit të librit Komunikimi Muzeor, vëllimi I-rë dhe II-të, vepër e cila konsiderohet çelës për të hapëruar në botën e komunikimit të mirëfilltë muzeoro-trashëgimor.



- Pjesëmarrje dhe fjalë rasti në Qendrën “Don Bosko” në Prishtinë, me rastin e ditës së Shkollës!
Në emër të MKRS-së, urova nxënësit dhe stafin e QSE “Don Bosko”, të cilët për Festën e Ditës së Shkollës kishin përgatitur një program të larmishëm kulturo-artistik me këngë, vallëzim, poezi, dramë, dhe ndarje të mirënjohjeve. Kjo festë ishte e rëndësisë së veçantë sepse shënohet në vitin Jubilar, të Skenderbeut dhe Pavarësisë së Kosovës.




- Pjesëmarrje si paneliste në Tryezën me temën "Rinia kosovare në dekadën e parë të Pavarësisë" të organizuar nga Kuvendi i të rinjve të Kosovës, në të cilën diskutuam për sfidat, arritjet dhe objektivat e rinisë në dekadën e parë të shtetësisë. Rinia është shtylla e vendit tonë, andaj meritojnë përkrahjen maksimale nga Institucionet tona.



- Në 10-vjetorin e Pavarësisë së Kosovës, MKRS-ja ndau çmimet për letërsi. Në kuadër të aktiviteteve të organizuara sipas agjendës shtetërore për 10-vjetorin e Pavarësisë së Kosovës, Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, në një ceremoni, ka bërë ndarjen e Çmimit Kombëtar për Vepër Jetësore "Azem Shkreli" dhe për Çmimet Vjetore për Letërsi.



- Pjesëmarrje dhe fjalë rasti në Hapjen e Ekspozitës “ 40 Sarandat” të organizuar nga Muzeu i Kosovës dhe Ambasada e Shqipërisë në Kosovë.



Faqe 14 nga 30

- Takim-Kërcyesit e Urës - Kampioni Florid Gashi, Shkelzen Goçi dhe trajneri Avdyl Osmani, Tomor Musa lidhur me mbështetjen e këtij aktiviteti sportiv në mënyrë që t'i kthehet nami kësaj tradite shumëvjeçare.



- Muzeu i Kosovës, pjesëmarrje në Hapjen e Ekspozitës Bazëë. Ekspozate të periudhave të ndryshme të trashëgimisë kulturore nga periudha e Neolitit e deri te Shpallja e Pavarësisë së Kosovës më 2008, janë prezantuar në hapjen e 'Ekspozitës Bazë' në Muzeun e Kosovës, e para e konceptuar si e këtitllë.



- Fjalën hyrëse në 140 vjetorin e Dëbimit të Shqiptarëve nga Sanxhaku i Nishit - në Bibliotekën Kombëtare “Pjetër Bogdani” (Ekspozite: Dëbimi i shqiptarëve nga Sanxhaku i Nishit përgaditur nga Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës).



- Ftesë- Në Amfiteatrin e Bibliotekës Kombëtare “Pjetër Bogdani” u shfaq filmi dokumentar ne kuadër të 140 vjetorit të Dëbimit të Shqiptarëve nga Sanxhaku i Nishit.



- Pjesëmarrje në Aktivitetin Epopeja e UÇK-së. Në përkujtim të 20 vjetorit të luftës dhe rënies heroike të Komandantit Legjendar të UÇK-së, Adem Jashari dhe Familjes Jashari, në Prishtinë, u mbajt ceremonia "Epopeja e UÇK-së".



Faqe 17 nga 30


- Pjesëmarrje dhe fjalë rasti në Qendrën e KFOR-it në Prishtinë ku u mbajt Konferenca Ndërkombëtare për Gruan, Paqen dhe Sigurinë në Kosovë, me ç'rast pata nderin që të pranishmeve t'iu drejtohem me një fjalë rasti.
Komandanti i KFOR-it Major General Salvatore CUOCI, më nderoi me Mirënjohje dhe Medalje të KFOR-it.



- Takim me përfaqësuesit e Organizatës Up With People, një organizatë ndërkombëtare me seli në Denver, SHBA, që përkrahë dhe promovon aktivitete rinore, të cilat kulmojnë me shfaqje artistike, me ç'rast 100 të rinjë përformojnë duke përçuar mesazhe të paqes, bashkëpunimit dhe vlerave njerëzore.
Up With People ka vendosur që këtë vit të performojë për herë të parë në Regjion dhe pikërisht këtë performancë ta bëjë në Kosovë. Me datat 26 dhe 27 Maj në Gjakovë, dhe 1 e 2 Qershor në Prishtinë, do të performojnë shfaqje muzikore dhe artistike në menyrë që të promovojnë vlerat e tolerancës, harmonisë dhe lidërshiptit.

Faqe 18 nga 30


MKRS është e dedikuar të përkrahë projekte të tilla që promovojnë Kosovën përmes lidhjeve shoqërore dhe ndërtimit të raporteve kulturore-artistike.



- Me rastin e 8 Marsit vizitë në shtëpinë e Pleqve në Prishtinë. Aksion simbolik për Gratë të cilat ishin ato që kanë mbajtur mbi supet e tyre peshën e rëndë të mbijetesës, të rezistencës paqësore, të luftës dhe pa dyshim që ndërtimi i paqes nuk mund të arrihej pa to.



- Pjesëmarrje dhe fjalë rasti në Organizimin e tryezës së diskutimit me temë “Avancimi i Agjendës për Barazi Gjinore dhe Fuqizimi i Grave në Kosovë parakusht për Zhvillim të Qëndrueshëm”, organizuar nga Agjencia për Barazi Gjinore në kuadër të Zyrës e Kryeministrit, e udhëhequr nga Kryeshefja Edi Gusia.



- Takim me Znj. Alexandra Papadopoulou, Shefja e EULEX-it
 Znj. Christina Davis, Drejtoreshë e Departamentit për Demokraci dhe Qeverisje në USAID/Kosovë,
 Znj. Darlene Grant, Drejtoresha e Korpusit të Paqes,
 Znj. Edi Gusia, Kryeshefe Ekzekutive, Agjencia për Barazi Gjinore
 Znj. Flora Macula, UN Women
 Znj. Rozafa Ukimeraj-Sekretare e Përgjithshme në MAPL


Faqe 20 nga 30



- Pjesëmarrje në takimin e organizuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për koordinimin e donatorëve të jashtëm për të diskutuar bashkë lidhur me gjendjen aktuale në fushën e kulturës dhe trashëgimisë kulturore, si edhe për prioritetet dhe objektivat që paraqiten nga MKRS-ja në kuadër të takimit me donatorë.



- Takim me Kampionin botëror të Kikboksit Shpejtim Ahmetaj i cili në fund të vitit 2017 e ka shkruar një epokë të re për sportin e Kosovës në arenën ndërkombëtare, pasi ka fituar titullin e kampionit botëror në kikboks në kategorinë 'WAKO PRO'.



- Pjesëmarrje dhe fjalë rasti me rastin e vënies së gurthemelit të Qendrës së Kulturës në Rogovë, edhe një herë u dëshmuar se Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ëshë e përkushtuar që përmes Investimeve Kapitale të ndikojë edhe në jetën kulturore të banorëve të Rogovës.

Për këtë Projekt Kapital, MKRS ka ndarë rreth 1 Milion Euro.



- Pjesëmarrje në “Java e Gruas 2018”. Gjatë Week of Women, me Drejtorin e NDI, z. Alexander Chavarria, znj. Pranvera Lipovica, Koordinatorë e Programit.



- Mbajtja e Ligjëratës në Javën e Gruas, të organizuar nga NDI dhe mbështetur nga USAID, isha e privilegjuar të ndaja eksperiencën time karshi pjesëmarrësve të kësaj gjenerate lidhur me identifikimin dhe artikulumin e problemeve dhe çështjeve me rëndësi për qytetarët; rëndësinë për t'i adresuar këto çështje te akterët e duhur dhe përfshirjen në procese vendimmarrëse.



Faqe 23 nga 30


- Takim-Drekë pune me tre ish-Ambasadorë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Laurie Fulton (Danimarkë), Colleen Bell (Hungari) dhe Sam Heins (Norvegji), me të cilët diskutuam rreth të arriturave dhe sfidave me të cilat përballen institucionet e Kosovës drejt konsolidimit të demokracisë dhe anëtarësimit në BE. Takimi është organizuar nga Ambasada Amerikane në Prishtinë dhe NDI.



- Takim-Përfaqesuesit e Klubit sportiv HCR Gjakova. Diskutuam për avansimin, përkrahjen dhe promovimin e mëtejme të këtij sporti i cili po shënon rezultate të mira në garat vendore dhe ndërkombëtare.



- Ndarja e çmimeve për Gentiana Beqa. Në një ceremoni të organizuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Ministri Kujtim Gashi, bëri ndarjen e shpërblimeve për sportisten Gentiana Beqa me çekun prej 10 mijë euro, dhe trajnerin e saj Elvin Beqa me çekun 5 mijë euro.



- Pjesëmarrje dhe fjalë rasti në Koncertin e organizuar në Pallatin e Kulturës “Asim Vokshi” Gjakovë “Perlat Shkodrane”. Në rolin e Zëvendës Ministres së MKRS-së kam përkrahur koncerte të tilla dhe do të vazhdoj përkrahjen e artistëve me vlera të mëdha për vendin tonë.



- Pjesëmarrje në ndarjen e çmimeve në fushën e Trashëgimisë të organizuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.
Adem Bungurit, iu nda Çmimi për Veprimtari jetësore “Dea Dardanicae”
Çmimin Vjetor për Merita të Veçanta “Shtjefën Gjeqovi” e mori Fatmir Peja – post mortum.

Çmimi Vjetor për Vepër Shkencore “Zef Mirdita”, iu nda Florina Jerliut, dhe
Çmimi Vjetor për Menaxhim Instutucional “Muhamed Shukriu”, iu nda Sabit Sylës.



- Takim-Drejtori i Arkivit Ndërkomunal të Gjakovës z.Valdrin Shehu, me të cilin diskutuam për bashkëpunimin e mëtejshëm të MKRS-së dhe ASHAK-ut me qëllim të përmbushjes së Misionit të tyre e që ka për qëllim grumbullimin, mbrojtjen, ruajtjen, rregullimin, përpunimin, publikimin, prezantimin dhe japjen në shfrytëzim lëndët arkivore për qëllime profesionale dhe shkencore.



- Takim-Me Kryetarin e Rahovecit në Rahovec Z. Smajl Latifi, nënkryetari Fatmir Iska, Afrim Dina kryesues i Kuvendit, dhe Ervin Hoxha drejtor i DKRS-së. Është biseduar për kërkesat thelbësore të kësaj Komune si dhe prioritetet e saj. Një ndër prioritet e kësaj Komune është përfundimi i shpejtë i palestrës së sporteve në Rahovec.



- Pjesëmarrje në Farewell Party (Ambasada Greke). Organizuar nga Ambasada Greke për nder të përfundimit të mandatit të Ambasadores Greke.
- Pjesëmarrje në Jakova Innovation Center- E organizuar nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Sesion informues për Platformën e hartimit të Biznes Planeve. Në takim ishte i pranishëm edhe Kryetari i Komunës së Gjakovës Ardian Gjini.



- Takim-Guy Mettan Deputet në Parlamentin kantonal në Gjenevë dhe Tahir Shabani President i shoqatës së miqësisë Franko-Shqiptare. Takim ky i cili shpreh gadishmërinë e themelimit të marrëdhënieve dhe organizimin kulturor në vazhdim të përpjekjeve të një bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare si dhe Institucionet tona. Me theks të veçantë favorizimin e Kulturës, Sportit dhe Rinisë në mes të Kosovës dhe Gjenevës, Brukselit, Frances.



- Pjesëmarrje dhe fjalë rasti në UBT konferenca “Roli i Klubit zviceran të shtypit dhe medieve në Gjenevë dhe diplomacia publike e parlamentare. Me ç’rast si përfaqësuese e institucioneve shpreha inkurajimin e studentëve që të bëhen forca e ndryshimit që i shtynë institucionet drejt marrjes së vendimeve të duhura.



- Pjesëmarrje në Manifestimin tradicional për “Ditët e Shqipërisë me rastin e 19 Vjetorit të Betejës së Kosharës. Në kompleksin Memorial të Brigadës 138 Agim Ramadani. Homazhe te Varrezat e dëshmorëve.



- Pjesëmarrje dhe fjalë rasti në Ekspozitën me temë “Parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm përmes artit”. Njëkohësisht takim me Ambasadorin e Mbretërisë së Norvegjisë zt. Per Strand Sjaastad dhe Ambasadorin e OSBE-së në Shqipëri zt. Bernd Borchardt, me të cilët diskutuam për shumë çështje dhe shprehëm gadishmërinë tonë për vazhdim të bashkëpunimit edhe në të ardhmen.



Faqe 29 nga 30